



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

Datë 09.02.2026

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

**Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE, QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2026.**

**Baza ligjore:**

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr.22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, VKM nr. 1093, datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit”, VKM nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së suvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në suvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Vendim i Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2026 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Shkresa nr.628/2 prot, datë 23.01.2026 e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, “Mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2026”, protokolluar me tonën nr.1413 prot, datë 28.01.2026.

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):**

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimeve, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e listës emërore hartuar nga Komisioni i Strehimit, të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e bonusit të strehimit që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në favor të Bashkisë Durrës për suvencionimin e qirasë për vitin 2026, sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fondet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët e Bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi: (PO/JO)**

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mbledhë më datë 09.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 8 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Pasi u hap mbledhja nga kryetari i komisionit dhe u pyet nëse kanë pyetje dhe kështu. Anëtarët nuk patën pyetje dhe kështu. Pika nr 8 u votua pro.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- \_\_\_\_\_

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

1 Kryetar

Marsida Feshti

2 Zv/Kryetar

Samir Osmani

3 Sekretar  
4 Anëtar  
5 Anëtar  
6 Anëtar  
7 Anëtar  
8 Anëtar  
9 Anëtar

Joniada Musaraj

Dorian Isaj

Elisabeta Mutaj

Flutura Kasa

Edlira Shemsi

Kontjana Kuçi

Erald Dalipi

Handwritten signatures and notes in blue ink. The notes include the name 'Silvone' and 'fesi' written in a cursive script. There are several scribbled-out signatures and initials.